



[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

# bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 10, korrik 2018



## Vendoset në Lezhë Këmbana e Paqes




Cryetari Frrokaj me Z. Haxhimali Fq. 4



Panair në Ditën Botërore të Bletëve fq. 7



Nis restaurimi i Memorialit Fq. 8



Lezha, qytet pa barriera, fq. 13



**Redaksia**

Drejtoria e Integrimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit  
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri  
Fotot: Olsi Tetaj  
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj  
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli  
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



Frokaj pret drejtorin Ekzekutiv të ShBSh	4
Mblidhet Këshilli Bashkiak i Lezhës	5
Degjesë publike për PBA	6
Dëmtohen parmakët e shetitores	6
<b>PANAIR NË DITËN BOTËRORE TË BLETËVE</b>	7
Nis restaurimi i Memorialit të Skënderbeut	8
Nis restaurimi i veprave të artit	9
Staron Projekti European 'Eu CAN'	9
Lezha Gatuan, Panairi i gastronomisë	10
Vendoset në Lezhë Këmbana e Paqes	11
Kryetari Frokaj uron festën e Bajramit	12
Lezha, qytet pa barriera	13
Biblioteka lëvizëse mbyll vitin	14
Poezia Prendit në takim me poetet Lezhjanë	15
Guidë turistike në Troshan të Lezhës	16
Faza e tretë e sterilizimit të qenve endacakë	18

## Frrokaj pret drejtorin Ekzekutiv të ShBSh, Agron Haxhimali

Kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj priti në një takim pune Drejtorin Ekzekutiv të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë z.Agron Haxhimali, në kuadër të bashkëpunimit me ekspertë ndërkombëtarë për mbrojtjen mjedisore "Projekti Energjia e Gjelbër (LOCAL4GREEN), mbi hartimin e politikave fiskale mjedisore, ku Bashkia Lezhë është përzgjedhur si bashki pilote.

Frrokaj garanoi se, institucioni që drejton e vlerëson kontributin e këtij projekti, teksa foli edhe për disa masa urgjente që duhet të ndërmerren në mjedis, ku erozioni më së shumti mbetet problem në zonat bregdetare. Kryebashkiaku garanoi ekspertët se, Bashkia Lezhë do të bashkëpunojë me çdo institucion shtetëror, shoqatë, organizatë apo dhe palë të tjera të interesuara për të ndikuar në mbrojtjen mjedisore. Nga ana tjetër, Z.Haxhimali shpalosi edhe qëllimin parësor të kësaj nisme ku nënvizoi se, synim i pro-

jektit është të ndihmojë bashkitë që të hartojnë dhe zbatojnë politika vendore fiskale inovative, të orientuara drejt promovimit të burimeve të energjisë së rinovueshme në sektorin publik-privat dhe në banesa. Për të diskutuar në detaje rreth këtij propozimi, Shoqata e Bashkive ka ftuar në një vizitë shkëmbimi experience, Francesco Filippin, Drejtor i Departamentit të Projekteve, Fondacioni MUSOL dhe Jose Llavata, Nënkryetar i bashkisë Quart de Poble nga Spanja për të asistuar Bashkitë Lezhë, Kukës dhe Vau Dejës si bashki pilote gjatë këtij procesi. Besard Kadia dhe Lorenc Gordani si ekspert lokal ndanë ekperiencën e tyre mbi energjinë dhe politikat fiskale që duhet të ndjekin bashkitë. Projekti Energjia e Gjelbër (LOCAL4GREEN) zbatuar nga Shoqata e Bashkive përgjatë 2017-2019 financohet nga Bashkimi European brenda Programit Interreg MED.



## Mbledhet Këshilli Bashkiak i Lezhës

Nën drejtimin e kryetarit Kristian Gjioda është mbledhur Këshilli Bashkiak i Lezhës. Me shumicë votash këshilli shqyrtoi dhe miratoi një sërë projektvendimesh që kishin të bënin kryesisht me dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30 qershor 2018, kompensimin e energjisë elektrike dhe dhënien e pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

Më pas u kalua në shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% si dhe rishqyrtimi i vendimit nr.70 datë 25.05.2018 të Këshillit të Bashkisë Lezhë; "Per miratimin e kalendarit të tokës bujqësore nga përdorim në pronësi të përfituesve". Si pikë e rëndësishme e rendit të ditës u paraqit dhe projektvendimi: "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 11 datë 29.01.2018, për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018 dhe në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.52 datë 25.04.2018. Ndërkohë u miratua dhe projektvendimi për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2019-2021 (faza e parë) të Bashkisë Lezhë. U miratua gjithashtu dhe përfundimi i procedurave të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Një debat pati edhe për problemin e faturave të prapambetura të furnizimit me ujë të pijshëm, për periudhën para vitit 2017, për disa lagje të Lezhës të cilat pretendojnë se nuk kanë patur kontratë të furnizimit me ujë të pijshëm dhe faturat u janë ngarkuar me pa të drejtë afrofe.

Në mbledhjen tjetër të këshillit u miratuan vendi-

met për ndihmën ekonomike për periudhën 1- 31 maj 2018, kompensimin e energjisë elektrike dhe dhënien e pagesës për personat me aftësi të kufizuar,

Ndërsa u miratua vendimi "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% si dhe projekt vendimi numër 3614 date 08.05.2018 për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për periudhën Janar-Prill 2018.

Si pikë e rëndësishme e rendit të ditës u paraqit dhe projekt vendimi për miratimin e hartës së zonave të administrimit të zhurmave për shërbimet publike në zonën e Shëngjinit gjatë këtij sezoni turistik. Ndërkohë u miratua dhe projekt vendimi për familjet e pastreha e në nevojë që do të trajtohen me subvencionim të qirasë së banesave për vitin 2018. U miratua gjithashtu dhe përfundimi i procedurave të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.



## Dëgjesë Publike mbi PBA 2019-2021

Në kuadër të përgatitjes për hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021, Bashkia Lezhë ka organizuar një dëgjesë publike me qytetarë dhe grupe interesi, ku është informuar rreth këtij draft programi. Zv.kryetari i bashkisë Enver Hafizi dhe drejtorë e drejtoresha pasi kanë prezantuar programet e hartuara kanë ftuar qytetarët që të jenë pjesë e këtij diskutimi dhe të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, me synim që ky draft program të jetë sa më afër interesave të publikut.

Takimi u karakterizua nga vullneti i mirë për të përfshirë komunitetin e Lezhës në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm që lidhet kryesisht me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe projekteve prioritare të Bashkisë gjatë këtij harku kohor.

Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, paketës fiskale, buxhetit vjetor dhe instrumentit të planifikimit financiar, Bashkia Lezhë asistohet nga Instituti i Kërkimeve Urbane përmes mbështetjes financiare të dldp-së.



## Dëmtohen parmakët e shetitores së lumit Drin

Bashkia Lezhë gjatë këtyre ditëve ka evidentuar dëmtime të pronës së përbashkët publike, probleme të cilat po i ndesh herë pas here, ku qytetarë të papërgjegjshëm dëmtojnë ambjentin. Në gjithë gjatësinë e shetitores, në të dy anët e saj, parmakët dekorativë-mbrojtës prej druri, janë dëmtuar në disa vende. Individë keqberës dhe të pandërgjegjshëm i kanë thyer dhe shkullur që andej.

Shëtitorja e lumit Drin është shëtitorja e gjithë lezhjanëve, ndaj të gjithë së bashku duhet ta mbrojmë nga dëmtimet të cilat janë kthyer në një shqetësim serioz. Bashkia Lezhë dënon akte të tilla dhe i bën thirrje çdo qytetari që jo vetëm të mbrojë mjedisin dhe qytetin nga veprime aspak të hijshme por të denoncojë akte të tilla në organet kompetente!



## BASHKIA LEZHË HAP PANAIR NË DITËN BOTËRORE TË BLETËVE

Në kuadrin e Ditës Botërore të Bletëve është organizuar në Lezhë panairi i prodhimeve të bletarisë; “Pa bletë s’ka jetë-Mbrojmë bletët, mbrojmë planetin”. Në panair morën pjesë 20 kompani të cilat kishin ekspozuar prodhimet e tyre shumë cilësore. Në këtë aktivitet promovues të organizuar nga Bashkia Lezhë, Fakulteti i mjekësisë veterinarë dhe “Farmvet Lezha” asistuan dhe bletërritës nga Kosova, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia. Kryebashkiaku Fran Frrokaj theksoi se institucioni bashkisë do të mbështesë evenimente të tilla që lidhen me zhvillimin e sektorit të bletarisë. Ndërsa zëvendësministrja e bujqësisë Ermira Gjeçi u shpreh se ky dikaster ka marrë masa për parandalimin e pesticideve që ndikojnë negativisht në sektorin e bletarisë dhe ndërkohë po subvencionon mbi 400 bletërritës që kanë aplikuar për mbështetje financiare nga qeveria. Koordinator i panairit, doktor i mjekësisë veterinarë Preng Pepa, evidenton faktin se duhen bërë përpjekje maksimale që kjo qënie shumë e rëndësishme, që sot ndjehet



e rrezikuar të zhvillohet duke qënë në shërbim të kulturave bujqësore dhe rritjes së prodhimit të mjaltit, dyllit dhe qumështit të mbretëreshës. Bletërritësi Jak Ndoja, që ka 50 vite që merret me bletari, bën një sugjerim që, panairë të tilla duhet të organizohen më shpesh pasi na njohin e na ndihmojnë në promovimin e prodhimeve tona të bletarisë. Pas vizitave në panair u organizua edhe një konferencë shkencore ku u fol për mbrojtjen e bletëve, nxitjen dhe mbështetjen e aftësive profesionale të bletërritësve, si një ndër mjeshtëritë më të njohura që në kohën ilire.

Nxitja e zotërimit të bletërritjes, ndërgjegjësimi i institucioneve e qytetarëve për rolin e pazëvendësueshëm të bletëve, inkurajimi për mbështetjen dhe promovimi i prodhimeve të bletarisë, inkurajimi i nxënësve dhe studenteve për të kultivuar bletët si mundësi për ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e të ardhurave, ishin mesazhet kryesore që u përçollën nga autoritetet pjesëmarrëse në konferencë.



# Nisin punimet për restaurimin e Memorialit të Skënderbeut

Kanë nisur punimet për restaurimin e Memorialit të Skënderbeut në Lezhë. Ky projekt me vlerë 30 milion lek, financohet nga Ministria e Kulturës dhe realizohet brenda vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit. Ndërhyrja do të bëhet e plotë jo vetëm në vendvarrimin e heroit por dhe në mjediset e jashtme të tij, deri tek porta hyrëse dhe muret e qytetit të poshtëm. Ka inspektuar punimet ministria e Kulturës Mirela Kumbaro e cila është shprehur se restaurimi nuk do të jetë i sipërfaqshëm në këtë monument kulture me vlera të rralla, për të cilin prej vitesh nuk janë bërë investime rehabilituese. Drejtori i Turizmit e kulturës pranë Bashkisë Lezhë Ardian Laçi i ka ngritur ministres problemin e ndërprerjes së vizitave në Memorial tani në periudhën e dyndjes së vizitorëve e turistëve të huaj dhe intensifikimin e punimeve për përfundimin sa më shpejt të projektit. Kumbaro ka argumentuar se është një koinçidencë jo e mirë, përplasja e sezonit turistik me kohën optimale për ndërhyrje të tilla që kërkojnë kohë të qëndrueshme e me diell.

Përgjegjësi i sektorit të trashëgimisë kulturore pranë Bashkisë Lezhë Paulin Zefi ka folur më në detaj për gjithë procedurat e punës restauruese që do të kryhen në këtë memorial.

Ky është maketi përfundimtar i restaurimit të Memorialit i cili pritet të përfundojë brenda këtij viti, i shpallur si viti mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeu.



# Nis restaurimi i veprave të artit Bashkia Lezhë mori pjesë në takimin e I të projektit 'Eu CAN'

Bashkia Lezhë në bashkëpunim me specialistët e Qendrës së Realizimit të Veprave të Artit, ka filluar punë për restaurimin e plotë të veprave monumentale prej bronzi që ndodhen në qendrën muzeale të qytetit tonë.

Skulptorët Fatmir Carkanji, Ilir Roshi dhe Kodrian Llalla, janë përfshirë në një proces të rëndësishëm pune që përkon me vitin dedikuar Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Siç bën të ditur përgjegjësi i sektorit të trashëgimisë kulturore pranë Bashkisë Lezhë Paulin Zefi, ka përfunduar faza e parë e reastaurimit të këtyre veprave dhe këto ditë pritet të filloi faza e dytë që do vijojë me restaurimin e pllakatit të madh "Shqiponja" vendosur në Memorialin e Gjergj Kastriotit Skënderbeu.



Bashkia Lezhë mori pjesë në takimin e parë të projektit 'European Counter & Alternatives Narratives Network' i cili u zhvillua në Paredes, Portugali. Së bashku me 12 bashki dhe organizata partnere si : Bashkia Paredes, Ëalk Together Association, Bashkia Guadassuar, Bashkia Demir Kapija, Koine Soc. Coop. Sociale, Alphabet Formation, Appis, Asociacija Apkabink Europa, Xano Channel , Bashkia Viareggio, Penthesileia, Monomyths Association nga e gjithë Europa u diskutua mbi migrimin dhe refugjatët të cilët janë shtuar në masë gjatë këtij 10 vjeçari. Projekti EUCAN ka si qëllim të promovojë të drejtat e njeriut, vlerat e Bashkimit Europian dhe të trajtojë valët e fjalimeve të urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit kundrejt emigrantëve dhe refugjatëve. Bashkia Lezhë në takimin e parë prezantoi situatën e përgjithshme të migrimit dhe refugjatëve në vendin tonë si dhe një përshkrim të përgjithshëm të situatës nëpër vite. Projekti ka 2 qëllime kryesore për të arritur: edukuese dhe ndërgjegjësuese. Gjatë 4 ditëve të aktivitetit u krijua një pamje e përgjithshme e të gjithë situatës së migrimit në Europë dhe azilkërkuesve.



# Lezha Gatuan

Për herë të parë, Bashkia Lezhë organizoi Festivalin e Gastronomisë "Lezha Gatuan". Merrnin pjesë restorantet më të njohur, kuzhinierët më të mirë, ku spikati një menu me plot krijmtari dhe shije, pa haruar gatimet tradicionale bio. Më shumë se një garë, festivali i gastronomisë synonte promovimin e gatimeve të traditës dhe të kuzhinës moderne me praktikë më konkurruese tani në prag të sezonit turistik. Zv.kryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku, duke vlerësuar si mjaft të arrirë organizimin e këtij festivali, theksoi se ky projekt meritonte të financohej nga dikasteret qendrore pasi promovonte Lezhën në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ministri i mjedisit dhe turizmit Blendi Klosi, u shpreh se festivali "Lezha Gatuan" ka gjithçka pozitive pasi ky sezon turistik nis me aktivitete të tilla. Ne i mbështesim këto nisma që vijnë nga bashkia, shoqata të shoqërisë civile, ato të promovimit të turizmit dhe shkolla të arsimit profesional. Këtu në Lezhë, vijoi Klosi, po gjëjmë gjithë atë kulinari të pasur që na duhet për një sezon turistik të shkëlqyer.

Në mjediset e sheshit para bashkisë Lezhë, tendat me gastronominë e ekspozuar, me një shumëllojshmëri gatimesh, qëndruan të hapura gjatë gjithë ditës.



# Vendoset në qytetin e Lezhës, Këmbana e Paqes

Në ditën e 1 Qershorit, festës së femijëve në sheshin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" u zhvillua një manifestim kulturor- sportiv, ku protagonistë ishin fëmijët dhe të rinjtë e Zadrimes "Ambasadorë të Paqes" dhe nxënës shkollash të qytetit dhe njësisive të tjera administrative. Ata demonstuan në shesh veprime koorografike, interpretuan këngë, valle popullore dhe krijime letrare dedikuar paqes. Me këtë rast u bë përrurimi i Këmbanës së Paqes vendosur në sheshin kryesor "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", me mbishkrimin: "Lezha qytet i Paqes". Janë "Ambasadorët e Paqes" me të rinjtë e Lezhës që vendosin këtë këmbanë, pasi besojnë në harmoninë fetare, në një rindërtim moral të ndërgjegjës të të gjithëve në shndërrimin e mjeteve të luftës në Këmbana Paqeje. Kjo është këmbana e dytë e Paqes, pas asaj të vendosur në Tiranë. Kjo këmbanë, u shpreh kreu i Bashkisë



se Lezhës Fran Frrokaj, është mesazh paqeje, mirëkuptimi e bashkëpunimi për të gjithë ne, ku paqja është shumë e domosdoshme edhe për fëmijët tanë dhe ardhmërinë e tyre. I peshkvi i Dioqezës së Lezhës Otavio Vittale, përshëndetjen dhe falenderimin ua adresoi femijëve "Ambasador të Paqes" dhe priftit të Zadrimes Don Antonio Sharra, që ishin të parët që me gëzhojat e armëve të zbratura në vitin e prapësht të 1997 bënë Këmbanën e Paqes. Famullitari i Zonës së Blinishtit, pasardhës i Sharrës, Don Enso, në fjalën e tij theksoi se, kjo këmbanë na kujton se nuk ka paqe pa drejtësi, nuk ka drejtësi pa dashuri, pa falje dhe nuk ka liri pa të vërtetën. Shoqëruar nga vokali i korit të femijëve të Zadrimes arqipeshkvi i Lezhës Otavio Vittale bëri bekimin e këmbanës, timbri i së cilës u degjua në gjithë qytetin. Në vazot e mëdha, vendosur në të dy anët e Këmbanës së Paqes u mbollën ullinj.



# Kryetari Frrokaj, i pranishëm në festimet e festës së Bajramit

Iftar tek restoranti “Stela” sponsorizuar nga kryebashkiaku zoti Fran Frrokaj për komunitetin mysliman të Lezhës me rastin e muajit të Ramazanit. Ishin të pranishëm myftiu Agim Tereziu, deputetja Lindita Metaliaj, zv.kryetari i bashkisë Enver Hafizi dhe besimtarë myslimanë të Lezhës. Agim Tereziu, pasi falenderoi zotin Frrokaj për financimin e këtij Iftari, foli për rëndësinë, vlerat dhe dobiet e Ramazanit për njeriun, familjen e shoqërinë. Në agjerim shfaqet forca e besimit dhe vendosmëria në adhurim, ku shpirtrat e besimtarëve manifestojnë nënshtrim ndaj urdhrave të Allahut. Me pas, duke uruar besimtarët myslimanë të Lezhës, me rastin e muajit të Ramazanit, përshëndeti dhe kreu i Bashkisë së Lezhës z.Fran Frrokaj. Ai theksoi se: “me agjerimin dhe sakrificën tuaj gjatë muajit të Ramazanit treguat vlerat e moralit dhe të besimit në Zot. Agjerim sa më të lehtë dhe paçi gjithnjë gëzime e lumturi në familjet tuaja! Zoti ua shperblefte sakrificën tuaj. Jemi shumë të kënaqur për bashkëjetesën dhe bashkëpunimin vëllazëror

mes besimeve, ç’ka është shumë e rëndësishme për kohën që jetojmë”.Sakrifica që ju bëni, u shpreh në fjalën e saj deputetja Lindita Metaliaj, ka sfiduar vesin dhe është e lidhur tërësisht me mirësinë, solidaritetin njerëzor dhe moralin tuaj të besimit.

Si çdo vit në ditën e Fiter Bajramit, besimtarë të Lezhës kanë falur namazin pranë xhamisë së qytetit, duke përcjellë mesazhe bashkëjetese vëllazërore mes besimeve. Kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj, deputetja znj.Lindita Metaliaj, zv.Kryetari Enver Hafizi, kreu i PD-së z.Paulin Marku dhe znj.Zyrafete Kulli, kryetare e PD-së së qytetit, përcollën urime për të gjithë besimtarët myslimanë nga Myftinia e Lezhës, ku u pritën nga myftiu Agim Tereziu. Ndërsa, vizites dhe urimit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë në Myftininë e Lezhës, iu bashkuan dhe fëmijë e të rinj të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, në një aktivitet sensibilizues me mesazhin e bukur e domethënës “Kemi Bajram e kemi Pashkë, dhe Shqipninë e kemi bashkë”.



# Lezha, qytet pa barriera

Gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2018, Bashkia Lezhë ka vijuar punën për të risistemuar trotualet në të gjithë qytetin për t'i përshtatur me rampa në mënyrë që të kthehet në një qytet pa barriera për të gjithë njerëzit, si në qytetin e Lezhës ashtu edhe në njësitë administrative, me qëllim lehtësimin e ecjes së nënave me fëmijë dhe personave me aftësi ndryshe. Ndërtimet e trotuareve në qytet asnjëherë nuk kishin parashikuar aksesin dhe lëvizshmërinë si të personave me aftësi të kufizuara ashtu edhe të nënave me fëmijë në karrocë, duke u kthyer në një problem i cili kishte kohë që kishte nevojë për ndërhyrje.



Gjatë kësaj kohe, Sektori i Shërbimeve në bashki, me shpenzime minimale, ndërmori nismën për të korigjuar të gjithë trotualet në qytetin e Lezhës. Tashmë qyteti i Lezhës po kthehet në një qytet pa barriera, i vetmi qytet që i ka larguar barrierat në të gjithë trotualet e tij. Aktualisht janë përfunduar 46 rampa në të gjitha segmentet kryesore të qytetit, në gjithë gjatësinë e Bulevardit "Gjergj Fishta", Rruga "Luigj Gurakuqi", rruga "Shtraus", Bulevardi "Papa gjon Pali II", Bulevardi "Faik Konica", rruga "Kosova", dhe po vijon puna për të rregulluar edhe rrugët e tjera të qytetit.



# Biblioteka lëvizëse mbyll vitin së bashku me shkollat

Mbyllja e vitit shkollor shenjon edhe mbarimin e vitit të dytë të Bibliotekës Shëtitëse - një praktikë që vazhdon të mbetet unike në Shqipëri dhe e përkrahur fort në nivel lokal dhe kombëtar.

Përgjatë rrugëtimit tonë u kemi shërbyer 2230 nxënësve në secilën shkollë të zonës rurale të Lezhës, nga të cilët 1375 janë vajza dhe 860 janë lexues djem. Deri në ditët e para të qershorit, kemi qënë në secilën shkollë për të mbledhur librat, duke lënë pas premtimin e ritakimit në Shtator dhe kënaqësinë e madhe të fryteve të një insiativë që ka afruar magjishëm fëmijët me librin dhe leximin.

Përgjatë periudhës shkollore ne kemi shpërndarë mbi 1200 libra në secilin prej 4 raundeve që ka mundur të bëjë Biblioteka Shëtitëse në 39 shkolla. E përkthyer në shifra: nxënësit e fshatrave të Lezhës kanë lexuar mbi 6000 libra, duke konsideruar se çdo anëtar i bibliotekës shëtitëse që ka marrë një libër, e ka qarkulluar atë me shokët dhe shoqet e veta. Këto mbeten vlerësime shumë të rezervuara e të mesatarizuara, pasi të vegjëlit e kanë shumë më të lartë kurben e qarkullimit; një nxënës i fillores e ndan librin e tij me minimalisht 6 shokë, të cilët e lexojnë një titull të shkruar vetëm një herë në kartelë.

Mirenjohje për kontributin e mësuesve, sidomos të ciklit të ulët, në qarkullimin dhe mirëmbajtjen e librave dhe krenari për fëmijët dhe të rinjtë që jo vetëm e duan dhe e kujdesin librin, por tanimë e kanë mik!



# Poezia e Arben Prendit në një takim me poetet Lezhjanë

Takimet poetike në Lezhë mbesin privilegj i poetëve, jo thjesht i lexuesve. Për të shfletuar Veprën Poetike të Arben Prendit, të shtunën, datë 23 Qershor, në Bibliotekën "Gjergj Fishta", ishin të shumtë miqtë e autorit e të poezisë; ata që e ridimensionojnë poezinë sipas përjetimit të tyre dhe poetët e Lezhës, që gjallojnë në frymën e vargut. Mes tyre edhe poeti Prendi, i lindur në Lezhë, tani profesor në Universitetin e Shkodrës, këtë herë mysafir në bibliotekë për të promovuar përmbledhjen e tij më të fundit me 7 cikle poetike.

Poeti Viktor Gjokolaj solli një rezyme analitike mbi rrugëtimin e Prendit si autor, ndërsa të gjithë bashkë lexuam poezi, duke i dhënë kështu mirëseardhjen e një produkti të ri letrar, që vetë autori e arsyeton kështu:

"... "Vepra poetike" përfshin një përzgjedhje të krijimtarisë time poetike dhe asht e strukturuar në shtatë cikle. Në ciklin e parë: "Thirrja e horizonteve", janë përmbledhë disa prej poezive të moshës 18-23 vjeçare, që nuk u botuen kur ishte koha e shkrimit të tyre, në vitet 1989-1995. Në tekstet e tyre janë ba disa krasitje të lehta, në të mirë të bukurisë poetike. Ndërsa në ciklin e dytë: "Të shtunën ndize një qiri" [1996], janë përzgjedhë një pjesë e mirë e poezive të botueme në këtë vëllim, i cili m'u duk se humbi si krija në ujë, aq sa prej shitjeve e dhurimeve, mbeta pa kopje personale. Pason cikli i tretë: "Vashat nguten me u ba gra" [1998], me poezi të zgjedhuna prej vëllimit me të njahtin titull, i cili qe pritë mirë prej lexuesit të parë. Gjithashtu në vijim asht edhe cikli i katërt: "Qirinj të ndezun për të gjallët" [2001], me poezi nga vëllimi me të njahtin titull. Për shkak të tirazhit të ulët, të tri vëllimet u zhdukën prej qarkullimit shumë shpejt, prandaj them se ribot-

imi i pjesshëm i tyne, u ba i nevojshëm. Tre ciklet e fundit, përkatësisht cikli i pestë, i gjashtë dhe i shtatë: "Akuarelet e jetës dhe të vdekjes" [2008-2015], "Fushave të amshimit" [2010] dhe "Pasqyrat e kohës" [2015], përbahen prej poezish të reja, të krijueme ndërmjet viteve të fundit 2000-2015, të pabotueme asnjëherë. Poezitë e kësaj përmbledhjeje, janë poezi të meditimit, reflektimit të ngjyrosun me ndjenjat e momentit poetik. Secila lidhet me një moment të caktuem meditimi e reflektimi për gjana të njoftuna në art, si: vetmia, trishtimi, dashunia, dhembja, vuetjta; e kaluemja, e tashmja, e ardhmja; jeta dhe vdekja, apo probleme të tjera të njeriut; motive këto të përjetshme në letërsi, por sekush sjell përvojën dhe shprehjen e tij poetike. Shpeshherë këto poezi synojnë qartësinë kuptimore dhe kur kjo nuk realizohet plotësisht, hyjnë në veprim imazhet poetike, pra atë që nuk e çon deri në fund arsyetimi dhe reflektimi e plotëson gjuha e imazheve, që i drejtohet synit të imagjinatës. Nuk kam synue me ecë nëpër shtigje të reja të kërkimit poetik apo me zbulue "toka të reja", por në toka të vjetra e të njohuna me mbjellë bimët e mia personale..."

Faleminderit secilit prej lexuesve e mirenjohje për "buken e shpirtit" qe ushqen Lezha, sot e kesaj dite!





# Guidë turistike në Troshan të Lezhës

Zadrimea e Lezhës me fushat e pafundme është një zonë me potencial të konsiderueshem ekonomik por dhe me një kulturë të adminirueshme, histori të lavdishme dhe resurse turistike me vlera unike në rajon. Destinacionet historiko-turistike të saj i gjen në shumë fashatra piktoresk të kësaj krahine. Për të njohur dhe promovuar me mirë këto vlera restoranti “Hylli i Drites” në Troshan në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë dhe agjensi të ndryshme turistike që operojnë në rrethe të ndryshme të vendit, organizuan një Guidë Turistike ditore me intenerar fshatrat Troshan, Krajn dhe Kallmet.

Me një program të detajuar dhe shumë premtues, pronarët e restorantit Preç dhe Fatmir Ndoi kishin marrë të gjitha masat për levizjen e vizitoreve e të ftuarve të tjere, për të parë të



gjitha pikat me interes historik dhe turistik që ofrojnë këto fshatra.

Ndlesa e parë bëhet në Kolegjin Françeskan në Troshan. I hapur ne vitin 1882, shpallur monumentet kulture, ai ka nxjerrë françeskanë të shquar, si at Gjergj Fishta, Shtjefën Gjeçovi, Pashko Bardhi dhe Vinçens Prendushi, që studiuuan dhe shërbyen këtu, duke lënë gjurmë në historinë dhe kulturën shqiptare. Prifti pader Kol Baruti dhe përgjegjësi i sektorit të trashëgimisë kulturore pranë bashkisë Lezhë Paulin Zefi shprehen më hollësisht për historinë e këtij kolegji dhe kontributin e këtyre klerikeve atdhetare.

Më pas u ngjitëm në drejtim të “Shkrepit të Kishës”, aty ku ndodhet Kisha e ShënNdout, pikdrisht vendi që ddshmon historinë e herëshme



të Françeskanëve të fshatit Troshan, që daton në vitin e largët, 1639. Një kishë e vjetër kjo por mjaft e vizitueshme nga besimtarë dhe turist të huaj.

Fshati Krajn ka qenë pika tjetër e kësaj guide. Ne ndaluam në studion e qeramikës të Vasil Kukajt, i cili prej afër 20-vitesh, ushtron këtë profesion. Ai me mjeshtërinë e tij po u jep prodhimeve të baltës forma artistike mjaft të pëlqyeshme për tregun vendas dhe të huaj.

Ndërkohë, u futëm në disa shtëpi dhe ndjemë

***Kolegji Françeskan në Troshan i hapur në vitin 1882, shpallur monument kulture, ka nxjerrë françeskanë të shquar, si at Gjergj Fishta, Shtjefën Gjeçovi, Pashko Bardhi dhe Vinçens Prendushi, që studiuuan dhe shërbyen këtu, duke lënë gjurmë në historinë dhe kulturën shqiptare.***



nga afër mikpritjen e bujarinë e zadrimeve të Troshanit, që të servirin vetëm produkte ushqimore bio. Pasi u ngjitëm rrezë malit të Velës e vizituam dhe fermën e Preçit dhe Fatmirit kemi zbritur dhe jemi ftuar për një drekë tek restoranti i tyre “Hylli i Drites”, i cili furnizohet me prodhimet bio të fermës së ngritur lart në bjeshkë. Aty, në mënyrë kronologjike, çdo bujtës, vizitor e turist i huaj prek dhe shikon nga afër gjithë procedurën e një kuzhine bio, që nis nga ferma dhe perfundon në piaten tënde. Pjesëmarrësit shprehin konsideratat dhe vlerësimet e tyre mjaft pozitive për këtë guidë ditore turistike. Drejtori i Turizmit, Arsimit dhe Kulturës pranë Bashkisë Lezhë Ardian Laçi, e vlerësoi si mjaft të frutshëm këtë bashkëpunim me biznesin privat në promovimin e vlerave historike e turistike të zonës së zadrimes ne përgjithësi dhe të fshatit Troshan ne veçanti. Kështu, pas një guide ditore mjaft atraktive, largohemi nga Troshani i Lezhës me dëshirën për t’u rikthyer sërish.



# Faza e tretë e sterilizimit të qenve endacakë

Bashkia Lezhë, organizata “Jeta Tier Und Mensch” dhe grupi i vullnetarëve “Help Animal Lezha”, fushatë për sterilizimin e qenve endacakë dhe rehabilitimin e tyre duke ngritur një qendër të posaçme. Në 6-mujorin e dytë të vitit të kaluar, Bashkia Lezhë hartoi dhe zbatoi Plan Veprimin për administrimin e qenve endacakë në qytet, plan i cili rezultoi efektiv, por problemi i tyre i kalon kufijtë e kompetencave tona, për faktin se kujdesi dhe trajtimi i tyre kërkon kosto të lartë. Me qëllimin kryesor, përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë publike po fillon të zbatohet një program gjithëpërfshirës dhe të prouar shkencërisht, me metoda të pranuar ndërkombëtare për të nxitur mbajtjen e përgjegjshme të qenve, në mënyrë që numri i qenve endacakë në territorin e Bashkisë Lezhë të zvogëlohet në mënyrë humane. Ky program zhvillohet në bashkëpunim me Organizatën “Jeta Tier Und Mensch” përfaqësuar nga Zj.Jenny Muller, veteriner si dhe grupi i vullnetarëve “Help Animal Lezha”. Proçesi ka filluar me trajtimin e qenve nga ana e veterinerëve, pra kastrimin/sterilizimin, vaksinimin dhe mjekimin e tyre. Më pas do të fillojë faza e sensibilizimit rreth këtij programi me ndihmën e vullnetarëve, veterinerë, fëmijë dhe nxënës të shkollave për të diskutuar mbi tematika të ndryshme të lidhura me mirëqenien e kafshëve dhe raportit njeri-kafshë. Me anë të këtij programi synojmë të ndikojmë në përmirësimin e shëndetit publik dhe situatës së krijuar nga prania e qenve endacakë duke dhënë alternativa për trajtimin e tyre dhe duke promovuar shërbime të profesionalizuara për kafshët.



## Kopshtet dhe çerdhja janë të hapura gjatë gjithë sezonit veror.

Bashkia Lezhë njofton prindërit dhe opinion publik se, kopshtet dhe çerdhja e qytetit do të qëndrojnë hapur gjatë gjithë verës me përjashtim të festave zyrtare. Çdo prind mund të dërgojë fëmijën në këto institucione duke respektuar orarin e proçesit edukativ sipas rregullores së brendshme të kopshteve dhe çerdhes


## Deklaratë për shtyp e Bashkisë për situatën e gurëve ne aksin Lezhë- Shëngjin


Lidhur me ngjarjen në Shëngjin,ku është shkëputur një masiv gurësh që ka goditur më pas një autobus udhëtarësh duke sjellë plagosjen e dy shtetaseve,Bashkia Lezhë së pari iu uron shërim sa më të shpejtë të lënduarave,ndërsa sqaron opinion publik se ky aks rrugor nuk është në varësi të bashkisë por Autoritetit Rrugor Shqiptarë.

Sa më lart,Bashkia Lezhë ka evidentuar që në vitin 2017,rrezikun e madh për rënie guresh në disa zona të Lezhës,ku rrishti më i lartë vijon të mbetet si në këtë rrugë,në Pallnë ashtu dhe në segmentin Balldre - Torovicë,akse nacionale.

Të gjendur në rrethana të tilla,bashkia ka kërkuar ndërhyrjen e autoriteteve përgjegjëse që menaxhojnë probeme të tilla me forca xhenjerë.

Bashkia Lezhë shpreh gadishmërinë për bashkëpunim maksimal me Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe çdo institucion tjetër shtetërorë për zgjidhjen sa më parë të këtyre rreziqeve që iu kanosën qytetarëve. Faleminderit !





Bashkia Lezhë,  
Lagjia Skënderbeg,  
Sheshi "Gjergj Kastrioti",  
4501, Lezhë,  
[info@lezha.gov.al](mailto:info@lezha.gov.al)  
[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)